

# NJË FJALOR I RI I TERMAVE THEMELORË TË BUJQËSISË, TIRANË 2006

(A NEW DICTIONARY OF BASIC AGRICULTURAL TERMS)

Vilma PROKO (JAZEXHIU)

Qendra e Enciklopedisë Shqiptare, Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë,

SHQIPËRI


E-mail: [vilmaproko@yahoo.it](mailto:vilmaproko@yahoo.it)

## PËRMBLEDHJE

Terminologjia e bujqësisë ka lindur në vijim të veprimtarisë praktike të njeriut dhe mbi bazën e veprimtarisë njohëse shkencore në fushën përkatëse. Ky leksik (bujqësor), i ndërtuar mbi bazën e brumit shqip dhe gjedheve fjalëformuese në tërësinë e vet, bën që t'u përgjigjet më mirë kërkesave që paraqiten ndaj termave për të qenë të kuptueshëm, të përpiktë e të motivueshëm. Dokumentimin e tij e gjejmë qysh te *Fjalori latinisht-shqip* (1635) i Frang Bardhit, duke përfshirë edhe fjalorët e tjerë dygjuhësh. Leksikun bujqësor në një fjalor të specializuar e ndeshim në fjalorin e parë terminologjik të fushës së bujqësisë (*Fjaluer Teknik Bujqësuer (shqip-italisht, italisht-shqip)*), Tiranë, 1935, të Mario Bindonit. Ky leksik shërbeu si bazë për zhvillimin e terminologjisë së bujqësisë në periudhën e fundit të formësimit të saj si sistem konceptor-leksikor pas viteve '50-'60 të shek. XX, një konkretizim i mëtejshëm i kësaj pune që dhe hartimi i *Fjalorit të bujqësisë (shqip-latinisht-italisht-rusisht)* i docent Niko Qafëzezit me rreth 20 mijë terma (852 f., Tiranë, 1978), i cili plotësoi një boshllëk të ndjeshëm në lëmin e shkencave bujqësore të kohës. Në funksion të kësaj ideje është edhe hartimi i veprës *Fjalor i termave themelore të bujqësisë (shqip-anglisht-frëngjisht-italisht-rusisht)*, Tiranë, 2006, fryt i një pune disavjeçare të ndërmarrë nga

Departamenti i leksikologjisë dhe i terminologjisë i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë të Akademisë së Shkencave në bashkëpunim me departamentet mësimore shkencore të Universitetit Bujqësor të

Tiranës. *Fjalori* ngërthen një termës prej 5000 njësisish. Ai paraqitet në rend sistematik (tematik) sipas fushave, nënfushave dhe mikrofushave të degëve të ndryshme të bujqësisë, me përkufizime shqipe, me barasvlerësit në gjuhët angleze, frënge, italiane, ruse, si edhe me treguesit përkatës të këtyre gjuhëve. Nga pikëpamja e ndërtimit makrostrukturor përfshin termat themelore të tri degëve kryesore të bujqësisë, të agronomisë, të pylltarisë dhe të veterinarisë, secila e përfaqësuar me një varg fushash, nënfushash e mikrofushash, të



paraqitura në sistem dhe në mënyrë hierarkike dhe alfabetike.

**Fjalë kyçe:** *term, terminologji, fjalor terminologjik, leksik bujqësor, fushë, nënfushë, mikrofushë.*

**Key words:** *term, terminology, dictionary of terms (thesaurus), agricultural lexique, subdomain, microdomain.*

## HYRJE

Terminologjia si fushë gjuhësore është bërë prej kohësh objekt shqyrtimi prej studiuesve, si në suazën e problematikës së përgjithshme të gjuhës shqipe, ashtu edhe në vështrimin më të ngushtë brenda problematikës që ngërthen terminologjia në vetvete. Prof. E. Çabej ka theksuar se “Një ndër detyrat kryesore të gjuhësisë shqipe, krahas kërkimeve teorike, është edhe mbetet pasurimi i gjuhës me elemente të gurrave vetjake dhe pastrimi i saj prej masës së fjalëve të huaja që kanë vërshuar së jashtmi dhe që po vërshojnë edhe në ditët tona” (Çabej: 5).

Në bazë të konceptimit, tashmë të pranuar, që terminologjia shihet si sistem termash (*Fjalor i termave themelore të bujqësisë: “Parathënie”*) që përfaqësojnë një sistem konceptesh të një fushe të dijes, çdo terminologji përbën një informacion të mirëfilltë shkencor dhe paraqet në mënyrë të kondensuar e të përmbledhur fushën përkatëse të dijes.

Përsa i përket terminologjisë së bujqësisë, ajo ka lindur në vijim të veprimtarisë praktike të njeriut dhe mbi bazën e veprimtarisë njohëse shkencore në fushën përkatëse. Ky leksik (bujqësor), i ndërtuar mbi bazën e brumit shqip dhe gjedheve fjalëformuese në tërësinë e vet, bën që t’u përgjigjet më mirë kërkesave që paraqiten ndaj termave për të qenë të kuptueshëm, të përpiktë e të motivueshëm. Ai identifikohet, si në rrafshin e fiksimit të tij në gjuhë, kryesisht nëpër fjalorë, të cilët janë ndër burimet bazë të dokumentimit të tij, ashtu edhe nga përdorimi i tij në dialekte, të cilat pasqyrojnë edhe fazat e hershme të zhvillimit të këtij leksiku.

Duke gjykuar mbi dokumentimin e leksikut bujqësor në fjalorët e ndryshëm qysh nga *Fjalori latinisht-shqip* (1635) i Frang Bardhit, duke përfshirë edhe fjalorët e tjerë dygjuhësh, mund ta

konsideronim këtë periudhë si fazë joterminologjike të zhvillimit të këtij leksiku deri në vitin 1900. Si fazë paraterminologjike mund të konsideronim periudhën pas vitit 1900 deri në vitet ‘20-’30, që fillon me leksikon e fiksuar në *Fjalorin* e Kristoforidhit (1904), ku në fillësë shohim disa mikrolidhje sistemore të këtij leksiku, të pasqyruara edhe në ato fjalëformuese, sipas të cilit mund të bëhet një farë klasifikimi i leksikut në fjalë në fusha, mikrofusha dhe në elementet përbërëse të tyre, një pjesë e të cilit ka ardhur si i tillë deri në ditët tona, duke qëndruar në bazë të sistemit të sotëm terminologjik të bujqësisë.

Leksikon bujqësor në një fjalor të specializuar e ndeshim në fjalorin e parë terminologjik të fushës së bujqësisë (*Fjaluer Teknik Bujqësuer (shqip-italisht, italisht-shqip)*, Tiranë, 1935 të Mario Bindonit, kur në zanafillë terminologjia e bujqësisë po fillonte të mëvetësohej si fushë e veçantë e dijes dhe po ngruhej në sistem, duke u përvijuar si veprimtari praktike dhe si shkencë e zbatuar në kuadrin e fushave të tjera të dijes.

Ky leksik shërbeu si bazë për zhvillimin e terminologjisë së bujqësisë në periudhën e fundit të formësimit të saj si sistem konceptor-leksikor pas viteve ‘50-’60 të shek. XX, e cila mund të konsiderohet si fazë terminologjike, e cila zuri fill në kushtet e reja ekonomiko-sociale, kulturore, arsimore në vendin tonë. Kështu, zgjerimi i fushave të veprimtarisë bujqësore si praktikë dhe si fushë e dijes u pasqyrua në shtimin e fushave leksikore terminologjike si koncepte shkencore, që çuan në krijimin e sistemeve të para terminologjike.

Një konkretizim i mëtejshëm i kësaj pune që dhe hartimi i *Fjalorit të bujqësisë (shqip-latinisht-italisht-rusisht)* i docent Niko Qafëzezi me rreth 20 mijë terma (852 f., Tiranë, 1978), i cili plotësoi një boshllëk të ndjeshëm në lëmin e shkencave bujqësore dhe që një kontribut i vyer në pasurimin e terminologjisë tekniko-shkencore të kohës, pasi me treguesit në gjuhët latinisht, italisht dhe rusisht i shërbeu shfrytëzimit të literaturës bujqësore të huaj.

Me zhvillimin në sasi e në cilësi të kësaj terminologjie u bë e nevojshme që kjo tërësi termash të krijuar pjesërisht në mënyrë të vetvetishme ose të rastit e pjesërisht në mënyrë të qëllimshme, t’i

nënshtrohet një shqyrtimi e sistemimi tërësor. Për këtë doli e nevojshme, krahas mbështetjes teorike, të dalë nga përgjithësimi i përvojës në rrafshin e teorisë së përgjithshme të terminologjisë dhe të asaj shqipe në veçanti, edhe veprimtaria në praktikën terminologjike, e konkretizuar me daljen në dritë të një vargu fjalorësh terminologjikë, ku për shqipërimin e termave duhet mbajtur gjithnjë parasysh kriteri që të “shqipërohen termat shkencorë jondërkombëtarë” (*Fjalori i terminologjisë tekniko-shkencore nr.1: 7*) dhe njëkohësisht “të shqipërohen edhe disa terma ndërkombëtarë, kur ka mundësi që shqipja t’i japë këto me fjalë të qarta nga brumi i vet” (*Fjalori i terminologjisë tekniko-shkencore nr.1: 8*).

Në funksion të kësaj ideje është edhe hartimi i veprës *Fjalori i termave themelorë të bujqësisë (shqip-anglisht-frëngjisht-italisht-rusisht)*, Tiranë, 2006. Fjalori është fryt i një pune disavejeçare të ndërmarrë nga Departamenti i leksikologjisë dhe i terminologjisë i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë të Akademisë së Shkencave në bashkëpunim me departamentet mësimore shkencore të Universitetit Bujqësor të Tiranës. Hartimi i tij është ndërmarrë nga një grup i madh specialistësh, pedagogë të UBT-së si prof. Adem Salillari, Myzafer Çela, Xhelo Sulo, Agim Hasko etj. me kryeredaktor terminologun prof. Agron Duro. Ky fakt e ngre *Fjalorin* në një vepër të autoritetshme dhe me vlera cilësore. Secili autor ka derdhur në të përvojën e punës në fushën e vet të ngushtë.

*Fjalori* është i veçantë në llojin e vet meqë ndërthen një termës prej 5000 njësisish. Ai paraqitet në rend sistematik (tematik) sipas fushave, nënfushave dhe mikrofushave të degëve të ndryshme të bujqësisë, me përkufizime shqipe, me barasvlerësit në gjuhët angleze, frënge, italiane, ruse, si edhe me treguesit përkatës të këtyre gjuhëve. Nga pikëpamja e formës dhe e përmbajtjes paraqitet si tip i veçantë fjalori terminologjik në krahasim me fjalorët e tjerë terminologjikë të serisë së hartuar nga Sektori i terminologjisë së Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, por në thelbin e vet, siç thuhet edhe në Parathënie të tij “lidhur me zgjidhjen e problemeve të rregullimit, njësimimit (standardizimit) dhe shqipërimimit të kësaj terminologjie, përbën një hallkë në këto seri” (*Fjalori i*

*termave themelorë të bujqësisë: “Parathënie”*).

Për hartimin e *Fjalorit* janë shfrytëzuar vepra terminografike të kësaj fushe, si të autorëve shqiptarë: *Fjalori i bujqësisë (shqip-latinisht-italisht-rusisht)* i N. Qafëzezit (Tiranë, 1978), *Fjalori i botanikës* (i serisë terminologjike 1, sektori i terminologjisë, IGJL, Tiranë, 1963), ashtu edhe të huaj, *Vocabulary of Agriculture* (English-Russian 70.000 terma, Moskva, 1983), *Vocabulary of Agriculture* (German-English-French-Italian-Russian, 10.000 terma, 1989). Në mënyrë të veçantë grupi hartues është mbështetur në terminologjinë e fushave të bujqësisë që pasqyrohet në fjalorët terminologjikë të botuar në vendin tonë, në letërsinë mësimore e shkencore të kësaj dege, e cila është vjelë, është përpunuar dhe është përgatitur si lëndë bazë për hartimin e fjalorit.

Struktura e tij është ndërtuar mbi bazën e raporteve të fushave të ndryshme të bujqësisë. Fillon me terma që kanë një përdorim më të përgjithshëm, siç është ekonomia bujqësore, ekologjia bujqësore, pastaj kalohet në terma që lidhen me tokën, pedologji, agrokimi, përmirësim ujqor. Nga këto kalohet në termat e ekologjisë dhe të zooveterinarisë, si dhe në ato të klimatologjisë, që lidhet me tokën dhe përmirësimin e saj, prodhimin e bimëve dhe rriprodhimin e kafshëve. Mandej kalohet në terma që lidhen me disiplinat fundamentale si gjenetika, kalohet në termat e botanikës, fiziologjisë, biokimisë, të përmirësimit gjenetik dhe bioteknologjisë. Duhet thënë se këto terma kanë të bëjnë me biologjinë, teknologjinë dhe veprimtaritë që lidhen me gjithë prodhimin bimor, pavarësisht se ato mund të jenë për bimët e arave, perimet, pemët frutore etj. Nga ky këndvështrim *Fjalori* ka një ndërtim origjinal ndaj fjalorëve të tjerë që janë në përdorim. Pas paraqitjes së termave me përdorim të përgjithshëm, kalohet në terma që janë të specialiteteve të ndryshme të prodhimit të bimëve, duke filluar nga termat që lidhen me farat, bimët e arave, perimtarisë, frutikulturës, mbrojtjen e bimëve, mekanizimin etj.

Nga pikëpamja e ndërtimit makrostrukturor *Fjalori* përfshin termat themelorë të tri degëve kryesore të bujqësisë, të agronomisë, të pylltarisë dhe të veterinarisë, secila nga të cilat është përfaqësuar me një varg fushash, nënfushash e mik-

rofushash, të paraqitura në sistem dhe në mënyrë hierarkike dhe alfabetike. (Kështu jepen *veterinari-anatomi-trup kafshe-kokë-turi-sqep* etj.).

Në themel të hartimit të tij është "Koncepti i shkollës së Vjenës", i sintetizuar në idenë e Vysterit (Felber) mbi terminologjinë si sistem i organizuar, që i përgjigjet një sistemi konceptesh të fushës përkatëse të dijes. Një fjalor i një tipi të tillë, bazuar në parimet dhe metodat bashkëkohore të mënyrës së përpunimit të terminologjisë dhe të pasqyrimin të saj në të, ku përkufizimi i çdo termi dhe renditja tematike e tij e ngrenë atë në nivelin e një njësie emërtuese jo vetëm me vlera paraqitëse, por edhe me vlera të mirëfillta informuese e njohëse shkencore-mësimore, mund të shfrytëzohet më lehtë, por dhe mund të studiohet nga rrafshet e ndryshme.

Paraqitja e marrëdhënieve ndërmjet termave që shënojnë konceptet përkatëse dhe marrja parasysh e tyre gjatë përpunimit të terminologjisë së fushës përkatëse ndryshojnë kahun e punës që duhet bërë me terminologjinë dhe pikërisht si bazë identifikimi i termit s' duhet të bëhet termi, por koncepti. Kjo mënyrë vështrimi e terminologjisë, duke u mbështetur në parimet dhe kriteret shkencore terminologjike të përpikërisë, qartësisë, motivueshmërisë, sistemorisë etj., zbulon mangësitë e sistemit terminologjik të fushës përkatëse dhe nxjerr nevojën e rregullimit të saj në bazë të sistemit të koncepteve, d.m.th., heqjen e sinonimisë, duke zgjedhur termin më të përshtatshëm ndërmjet sinonimeve ose krijimin e termave të rinj për të rregulluar mospërputhjen një term = 2 koncepte. Sa më sipër realizohet nga gërshetimi i punës së gjuhëtarit terminolog me atë të specialistit të lëndës. I pari, i pajisur me njohuritë e anës gjuhësore të termave dhe, në përgjithësi, me njohuri mbi teorinë dhe praktikën e punës terminologjike, drejton punën e përgjithshme metodike-shkencore të përpunimit të terminologjisë, kurse i dyti, i pajisur me njohuritë mbi sistemin e koncepteve të fushës përkatëse dhe të përmbajtjes së tyre, kryen punën themelore shkencore të saj. Si hallkë e tretë, këtu futet specialisti kompjuterist, i cili përgatit programin sipas idesë së terminologut dhe specialistit të fushës. Ky bashkërendim procesesh e ngre motivimin në shkallën më të

lartë. Kështu, motivimi i termit në procesin e përpunimit të terminologjisë bëhet parim udhëheqës për ndërtimin e terminologjisë së fushës përkatëse të dijes. Duke u mbështetur edhe në arritjet bashkëkohore në përpunimin e terminologjisë së fushës përkatëse në gjuhët e tjera si në ang., fr., it., rus. etj. krijohet një terminologji e standardizuar.

Në këtë mënyrë, çdo njësi terminologjike përbën një njësi informacioni të mirëfilltë dhe si e tillë shërben për përvetësimin e dijes, për transmetimin e saj dhe për komunikimin ndërmjet specialistëve.

Paraqitja e terminologjisë mbi bazën e lidhjes së termave dhe të koncepteve dhe vendosja e këtyre të fundit në themel të punës terminologjike (terminografike) bëjnë të domosdoshëm ristrukturimin e skedës terminologjike, duke e pasuruar atë me të dhëna të shumta, si të dhëna mbi termin, konceptin dhe të dhëna plotësuese, të cilat mund të paraqiten në formë të lexueshme nga kompjuteri. Kjo lloj skede, e plotësuar nga specialistët e lëndës, sipas fushës që mbulon secili në bashkëpunim me terminologët, pasi diskutohet e redaktohet përfundimisht, regjistrohet në kompjuter në bazë të një programi të caktuar, duke përfutur fjalorin me rend sistematik dhe alfabetik si edhe treguesit përkatës të gjuhëve të huaja.

Vlerat e *Fjalorit* spikat në mënyrë të veçantë në mikrostrukturën dhe makrostrukturën e tij.

1. Në *Fjalor* jepen përkufizimet në mënyrë të thukët e të përpiktë. Kjo jep mundësi të rrokot drejt nga përdoruesi i fjalorit vlera kuptimore e funksionale e termit, i cili ndeshet edhe me terma të ndryshëm në gjuhë të tjera. Përkufizimet në shqip dhe barsvlerësit në anglisht, frëngjisht, italisht e rusisht plotësojnë njëri-tjetrin dhe rritin saktësinë shkencore të çdo termi.

2. Përmbajtja dhe ndërtimi strukturor i përkufizimeve, të cilat, ndryshe nga shpjegimet e kuptimeve leksikore në fjalorët filologjikë të përgjithshëm, përfshijnë elementet e koncepteve që përfaqësojnë gjuhësisht termat dhe vetë përkufizimet gjuhësore të tyre, sikundër veprohet edhe në veprat e tjera shkencore e në tekste mësimore.

3. Termat paraqiten në mënyrë të njësuar, duke përzgjedhur e dhënë në *Fjalor* si parësor dysorin më të përshtatshëm, ku edhe përkufizohet termi



në shqip. Ai jepet në mënyrë sintetike, koncize, të qartë dhe të kuptueshme.

4. Në Fjalor identifikohen dhe diferencohen më mirë konceptet, nëpërmjet paraqitjes në sistem, duke dhënë ndonjëherë nëpërmjet një shenje dy koncepte *bujqësi* (*bujqësi*<sub>1</sub>(5) dhe *bujqësi*<sub>2</sub>(6) ose tri koncepte *tokë*<sub>1</sub> "nga ana e të drejtës bujqësore" (23), *tokë*<sub>2</sub> "si objekt prodhimi" (24) dhe *tokë*<sub>3</sub> "si sipërfaqe që punohet" (1313).

5. Në Fjalor vend parësor zënë termat shqip (të shqipëruar), çka siguron qartësinë e tejdukshmërinë konceptore të tyre nëpërmjet rritjes së motivueshmërisë gjuhësore si p.sh.: *vezëz*-a (për *ovulë*), *gojëz*-a (për *ostiolë*), *organth*-i (për *organelë*), *rrënjëz*-a (për *radikul*), *mitak*-e (për *adventiv*), *zhardhok*-u (për *tuber*) *vetëpjalimim*-i (*autogami*), *lehonor*-e (*puerperal*), *pasndërzimor*-e (*postkoital*) etj.

6. Paraqitja e sistemeve leksiko-sintaksore, që janë nga më të pasurit në terminologjinë e bujqësisë, ku veçohen termat kyç që përbëjnë edhe bazën e leksikut terminologjik të bujqësisë, si: *tokë* {XE "tokë"} (me të gjithë lidhjet e mundshme leksiko-sintaksore si p.sh.:

{XE "tokë"} *tokë bujqësore* → *tokë koloidale* {XE "tokë koloidale"} → *tokë humusore* {XE "tokë humusore"} → *tokë humusore e ajrosur* {XE "tokë humusore e ajrosur"} etj.

7. Fjalori pasqyron drejt si traditën, ashtu edhe risitë në terminologjinë e kësaj fushe dhe me këtë mënyrë i jep mundësinë përdoruesit të tij të gjejë aty termat themelore që kanë dalë e dalin edhe sot në literaturën ose veprimtarinë praktike bujqësore. Ai pasqyron kënaqshëm ndryshimet që kanë ardhur në këtë terminologji nga ndryshimet e fundit në sistemin ekonomik të vendit tonë, në format e organizimit të veprimtarisë bujqësore etj.

8. Leksiku bujqësor në Fjalor është pasuruar edhe me togfjalësha. Togfjalëshat e qëndrueshëm terminologjikë janë të thjeshtë dhe të zgjeruar, me ndërtime fjalë shqipe + fjalë shqipe (*fuqi mbirëse*, *periudhë bimore* {XE "periudhë bimore"}, *përmirësim ujqor* {XE "përmirësim ujqor"}, *vyshkje kërpudhore* etj.), fjalë shqipe + fjalë e huaj (*faktor letal*, *organizëm autotrof*, *bimë karnivore*, *organ trunkat* etj.), fjalë e huaj + fjalë shqipe (*agregat shumëqelizor*, *rradiacion diellor*, *pulverizator me rripa*, *membranë njëqelizore* etj.), fjalë e

huaj + fjalë e huaj (*avulltranspirim efektiv*, *bakteriozë e agrumeve* {XE "agrumeve"}, *fitologji bujqësore*, *ujëra freatike* {XE "ujëra freatike"}, {XE "ujëra nëntokësore"} *vaditje* {XE "vaditje"} me *infiltrim*) etj.

9. Të gjithë përbërësit e Fjalorit janë sjellë rregullisht në një trajtë: pasqyrimi leksikografik i termave, strukturat logjike e formale të përkufizimeve, tipat strukturorë të termave, përmasat e nënsistemeve terminologjike dhe të elementeve leksikografike të pasqyrimin, deri te gjuha e tekstit etj. Kështu përmbajtjes shkencore i përgjigjet edhe një strukturim e trajtim shkencor leksikografik, duke përfituar nga përvoja vendase e botërore.

10. Nga pikëpamja e vlerës së përdorimit Fjalorit mund t'i drejtohen përdorues të kategorive të ndryshme; në mënyrë të veçantë mund të shfrytëzohet nga nxënësit e studentët, specialistët e fushave të ndryshme të bujqësisë, studiuesit, si të fushës së bujqësisë ashtu edhe të gjuhësisë. Shfrytëzimi i Fjalorit varet nga përgatitja dhe qëllimi që ka përdoruesi. Nëse përdoruesi është specialist i fushës së bujqësisë apo student i kësaj fushe mund ta trajtojë termin që kërkon si burim informacioni, kështu që mund të niset edhe nga tabela "Renditja tematike-sistematike e fushave dhe nënfushave", duke nënkuptuar se ai e di se në çfarë fushe ose mikrofushe futet termi. Kështu ai gjen termin që kërkon si burim informacioni në rrethin e termave të afërt me të. Në këtë rast Fjalori shndërrohet në formën e një doracaku. Nëse përdoruesi është një lexues i zakonshëm dhe interesohet për një term të caktuar, ai mund t'i drejtohet drejtpërdrejt paraqitjes alfabetike të Fjalorit në shqip.

Së fundi, ndërtimi i Fjalorit ndihmon përdorimin e lehtë të tij. Parathënia e shkurtër shqip dhe anglisht; treguesit e termave në katër gjuhë; lista e termave të huaj që janë shqipëruar në fjalor ose e termave shqip (ose të huaj) të saktësuar në lidhje me konceptet që shënojnë. Kështu Fjalori shërben edhe si mjet rishikimi dhe verifikimi të dijenive të përdoruesve, çka çon në përvetësimin nga ana e tyre të termave të standardizuar.

Fjalori mund të bëhet objekt studimi nga shumë anë dhe mund të shërbejë si model për të ndërmarre vepra të tjera të këtij lloji, duke i paraqitur ato

në mënyrë më cilësore sesa *Fjalori* në fjalë. Le të jetë ky *Fjalor* një shembull i mirë për të ndërmarrë në të ardhmen edhe nisma për hartimin e fjalorëve të tillë për fusha të tjera të dijes.

**BIBLIOGRAFIA**

ÇABEJ, E. (1984), *Për pastërtinë e gjuhës*, "Gjuha shqipe", nr. 3, Prishtinë.

*Fjalor i termave themelorë të bujqësisë (shqip-anglisht-frëngjisht-italisht-rusisht)* (2006), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë.

*Fjalori i terminologjisë tekniko-shkencore nr. 1* (1963), *Terminologjia e botanikës*, Instituti i Gjuhësisë dhe i Historisë, Tiranë.

4. FELBER H. (1984), *Terminology Manual*, Infoterm - Vienne, Paris.